VENDIM
Nr. 246, datë 18.5.2000

PËR NDRYSHIME TË KUSHTEVE TË LIDHJES SË KONTRATAVE TË SHITJES, PËR APARTAMENTET E NDËRTUARA ME FONDE SHTETËRORE NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 13 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995, "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha", me propozim të ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes me Entin Kombëtar të Banesave, blerësi do të paguajë vetëm vlerën prej 4 përqind të apartamentit. Kjo vlerë është e zbatueshme pavarësisht nga tipi i kontratës së shitblerjes së apartamenteve si dhe nga statusi i strehimit të qytetarit.

2. Pas pagesës së 4 përqindëshit, shlyerja e kredisë do të vazhdojë të kryhet me këste të rregullta mujore sipas vendimit nr.291, datë 21.6.1994, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e vlerësimit të apartamenteve të ndërtuara me fondet shtetërore" dhe udhëzimit nr.4, datë 22.4.1994, të Këshillit të Ministrave, "Për vlerësimin e apartamenteve që ndërtohen me fonde shtetërore".

3. Vendimi nr.528, datë 17.10.1994, i Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e pagesës së banesave që financohen nga Enti Kombëtar i Banesave", me ndryshimet e tij dhe vendimi nr.210, datë 1.4.1996, i Këshillit të Ministrave, "Për uljen e kështit të parë të pagesës së apartamenteve të ndërtuara me fonde shtetërore", shfuqizohen.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Enti Kombëtar i Banesave dhe Organet e Pushtetit Vendor.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta